



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 12/2019), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: DKSK) më 83- seanca e mbajtur më 27.02.2023 miratoi,

### **Vendim**

Procedura e kontrollit të të dhënave për gjendjen pronësore nga fleta anketuese i -----, drejtor, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-3093/1 të datës 12.06.2019.

Lënda me numër 08-3093/1 të datës 12.06.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetimin në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat kohor prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

### **Arsyetim**

Lënda me numër 08-3093/1 datë 12.06.2019 është formuar me iniciativë të saj, bazuar në Planin Vjetor të monitorimit të gjendjes pronësore dhe interesave për vitin 2019.

KSHPK-ja nga i emruari kërkoi anëtarët e familjes së tij me të cilët jeton në një familje të përbashkët.

Të dhënat e kërkuara janë dhënë nga personi i përmendur.

Për konstatimin e gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK-ja ka marrë të dhëna për pasurinë e ----- dhe familjarëve të tij nga Agjencia e Kadastrës, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Depozita Qendrore e Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KSHPK, nga të dhënat e marra nga institucionet e përmendura si dhe nga të dhënat nga fleta anketuese e dorëzuar nga i emëruari, konstaton se i emëruari nuk e ka paraqitur personin juridik Shoqëria për veprimtari shërbimi ----- SHP Shkup e themeluar me 19.02.2020. Vepra penale është e vjetëruar. Nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Nga sa më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së:

Përgatiti: BS, Bashkëpunëtor i lart

Miratoi: V.G., anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHETETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Nënkryetar

**Katica Nikolovska**

---